




DREJTORIA E ARSIMIT –KOMUNA E PEJËS

Bazuar në Udhëzimi Administrativ nr 02/2016 të MASHT-it për Aktivitet Jashtëshkollore si dhe në bazë të kërkesave të Drejtorëve të Shkollave të Mesme të Larta ,shkollat e mesme të larta ftojnë agjencitë turistike që të ofertojnë për organizimin e ekskursionit për maturant të shkollave të mesme në Komunën e Pejës për vitin shkollor 2026/2027 ,në Republikën e Shqipërisë.

FTESË PËR OFERTË PËR REALIZMIN E EKSKURSIONIT TË MATURANTËVE NË SHQIPËRI

- Gjimnazi “Bedri Pejani” 430 persona;
- ShML Teknike “Shaban Spahija” 260 persona;
- Shkolla e Mesme Ekonomike “Ali Hadri” 60 persona;
- Shkolla e Mesme e Arteve “Odhise Paskali” 75 persona;
- Shkolla e Mesme e Muzikës “Halit Kasapolli” 22 persona;
- Shkolla e Mesme e Mjekësisë 150 persona.

Ofertat e agjencisë tursistike duhet të përfshijnë çmimin për person.

Koha e qëndrimit do të jetë 5 ditë.

Itinerari do të përcaktohet nga drejtori i shkollës dhe mbikqyrësi i ekskursionit si vizitë qyteteve të Shkodrës,Krujës,Vlorës,Tiranës dhe Kalas së Durrësit.

Me lartë është paraqitur numri potencial i maturantëve pjesmarrës në ekskursion dhe ky numer mund të ndryshoj.

Agjencitë që ofertojnë duhet ti plotësojnë keto kushte:

- Të jetë i licensuar;
- Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave përkatëse ligjore dhe të ketë autobus të mjaftueshëm për nevoja të shkollës;
- Autobuset të jenë komfort dhe me klimë ;

-Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin mendor dhe fizik të ngasësve të autobusit;

-Agjencioni duhet të ketë perkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (çertifikat pune dhe diplomë të mjekut) që shoqron nxënësit.

-Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (liçencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;

-Akomodimi i maturanëve do të jetë në qytetin e Durrësit.

Komisioni me rastin e përzgjedhjes përveq kushteve të lartëshenuara do të marrë për bazë:

-Kualitetin dhe cilësinë e ofertës.

-Hotelin e preferuar nga shkolla.

-Dëshminë e rezervimeve në hotelin që plotëson kapacitetin për akomodimin e të gjithë nxënësve sipas shkollave përkatëse

Afati i ofertimit është 7 ditë nga dita e publikimit

Ofertat duhet të vendosen në pliko të mbyllur dhe të vulosur nga ana e ofertuesit si dhe duhet të shkruhet oferta për ekskursion për shkollën përkatëse.

Oferatat dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit –Komuna e Pejës cdo ditë pune nga data 14.08.2026 deri me 20.08.2026.

Data e fundit për dorëzimin e ofertave është 20.08.2026 ora 13:00

Hapja dhe vlerësimi i ofertave do të bëhet me datë 20.08.2026 ora 14:00 në Drejtorinë e Arsimit-Komuna e Pejës.